



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

**Drejtoria për Prokurim Publik**  
**14 Nr. 442/24**  
**Daët 15.07.2024**

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: **DEA GROUP SH.P.K-Prishtine**, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes të seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, me datën 15.07.2024, merr këtë:

**VENDIM**

- 1. Refuzohet Plotësishtë e pabazë Kërkesa për rishqyrtim e subjektit në procedurë : **DEA GROUP SH.P.K-Prishtine** lidhur me Njoftimin mbi Vendimin e AK –Prpozimet Teknike –Vlerësimi i Jurisë - Radhitja e Projekteve dhe qasjen ne dokumente nëkëtë aktivitetet të prokurimit me titull: *Konkurs per hartimin e projekteve per dizjanimin e urave me numër prokurimi: VU644-24-6198-2-2-3* inicuar nga AK – Komuna e Vushtrrisë.**
- 2. Vërtetohet Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e Tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: *Konkurs per hartimin e projekteve per dizjanimin e urave me numër prokurimi: VU644-24-6198-2-2-3* andaj AK – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë vazhdon më tutje me procedurën e prokurimit.**

**Arsy e t i m**

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të kërkesës së Njësisë Kërkuese ka inicuar aktivitetin e prokurimit me titull: *Konkurs per hartimin e projekteve per dizjanimin e urave me numër prokurimi: VU644-24-6198-2-2-3*

Më 12 korrik 2024, Autoriteti Kontraktues përmes platformës e-prokurimi ka pranuar Kërkesën për Rishqyrtim të parashtruar nga operatori ekonomik **DEA GROUP SH.P.K-Prishtine** kundër Njoftimin mbi Vendimin e AK –Prpozimet Teknike –Vlerësimi i Jurisë - Radhitja e Projekteve, arsyetimin e Kërkesës për rishqyrtim, **DEA GROUP SH.P.K-Prishtine** (në tekstin e mëtejme Ankuesi) pretendon se, A.K. Duke mos bërë vlerësim të drejte nga ana e AK - OE pjesmarrës ne këtë Aktivitet Prokurimi ju ka shkaktuar dëme materiale në vlere prej 5,000.00 Euro për përgaditejn e Koncept Projektit dhe Dokumentacionin e Kandidatit.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, gjatë fazës së shqyrtimit paraprak ka konstatuar se ankesa i përmban elementet e përcaktuara përmes nenit 60 paragrafi 3 të Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 108/A paragrafin 3.1 të LPP në procedurë paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë AK ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë kërkesë sipas nenit 108/A të LPP lidhur me nenin 63 të RRPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e saj në mënyrë meritore.

Autoriteti Kontraktues, pasi shqyrtoi një nga një pretendimet e OE ankues të parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim në kontekstin e përgjithshëm të kërkesave dhe kushteve të zbatueshme të dosjes së tenderit/njoftimit për kontratë, fakteve të pohuara nga OE ankues, duke pasur parasysh natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe duke u mbështetur në LPP dhe RRPP, **gjeti se kërkesa për rishqyrtim është e pabazë.**

1. Pretendimi i parë dhe i përgjithësuar i OE ankues është se se AK – NJK- Komuna Vushtrri i ka shkaktuar dëme me Njoftimin mbi Vendimin e AK –Prpozimet Teknike – Vlerësimi i Jurisë - Radhitja e Projekteve, OE-Ankuesit si dhe pretendon se nuk i është dhënë qasje e plotë në dokumentet e me këtë Ankuesi pretendon se AK ka bërë kufizimin apo diskriminimin në konkurrencë.

Përgjigja e AK-së: Lidhur me këtë pretendim, A.K. konstaton se është plotësishtë i pabazë pasi që OE ankues nuk ka arritur t'a argumentojë me asnjë fakt dhe provë se kjo kërkesë e kufizon ose ulë konkurrencën e lirë në treg dhe e diskriminon atë në këtë aktivitet të prokurimit.

AK- përmes postes elektronike i ka dhanë qasje në dokumente Ankuesit konform procedurave vetëm në Propozimet Teknike, sepse në këtë fazë Nuk është e lejuar zbulimi i identitetit të OE pjesëmarrës.

Tutje theksojm se të gjitha kërkesat për të pasur qasje dhe pretendimet për të rivlerësuar vetë e zbuluar votimin OE në zyrën dhe prezencën e AK janë kërkesa jo ligjore të quditshme dhe amatoreske.

AK- Konstaton se ky kufizim në qasje të dokumenteve dhe lejimi i pjesërishëm në qasje në dokumente në këtë fazë është i nevojshëm, relevante dhe proporcionale në raport me objektin, natyrën dhe vëllimin e natyrën specifike, të parapara në këtë aktivitet prokurimi dhe si e tillë mbetet në fuqi pasi që siguron konkurrencë të barabartë sipas nenit 7 të LPP-së për të gjithë OE që dëshirojnë të marrin pjesë në këtë aktivitet.

Sa i përket pohimeve të ngritura kinse për shkelje të neneve të LPP-së, A.K. thekson se ky pohim është paragjykses, pasi që në kontekstin e rrethanave konkrete kjo dispozitë nuk ka të bëjë me çështjen konkrete, respektivisht nuk është e aplikueshme ose nuk ndërlidhen në situatën dhe procedurën e tanishme të këtij aktiviteti të prokurimit.

---


Nga konteksti i lartcekur, A.K. i rikujton OE ankues se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë A.K. për njohjen e kapaciteteve minimale të OE, të cilët nëpërmjet dokumentacionit duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme të kapaciteteve ekonomike, financiare, teknike, profesionale, përvojën e duhur, personelin e nevojshëm dhe gjithçka tjetër në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në fund, A.K. thekson se vërtetohen dhe mbesin në fuqi të gjitha kërkesat, kushtet materiale dhe informatat tjera përkatëse të dosjes së tenderit sipas versionin të paraqitur, për arsye se të njejtat garantojnë transparencë dhe konkurrencë të drejtë e të barabartë sipas praktikave më të mira për të gjithë OE që zotërojnë kapacitetet e nevojshme të lartcekura në funksion të realizimit me sukses të kontratës në raport me objektin dhe specifikat e fushëveprimtarisë së saj.

Nga se u tha më lartë, e në pajtim me dispozitat e lartcekura, A.K. vlerëson se nuk ka asnjë arsye të vensosë ndryshe nga ajo që është theksuar si më lartë, andaj edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Drejtoria për Prokurim Publik

  
Ilmi Azemi

**Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtroi Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.**

Nga një kopje i dërgohet:

1x1 Palës/ ve;  
1x1 DPP, dhe  
1x1 Arkivit.